<p>parandalimin e rreziqeve në punë, as nga punëdhënësi, as nga të punësuarit e tjerë.</p> <p>3. Për të punësuarin e ngarkuar, i cili ushtron aktivitetet nga siguria dhe shëndeti në punë, punëdhënësi duhet të sigurojë trajnime dhe mjete të nevojshme për punë.</p> <p>4. Punëdhënësi, në mungesë të personelit të kualifikuar për të udhëhequr me sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda subjektit të tij do të angazhojë persona ose institucione për shërbime profesionale të jashtme.</p> <p>5. Ministria, me akt nënligjor, përcakton kushtet dhe kriteret, për certifikimin e personave dhe institucioneve për shërbime nga paragrafi 4 i këtij neni.</p> <p>6. Personat e jashtëm apo institucionet për të ushtruar aktivitetet nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të jenë të pajisura me mjetet dhe pajisjet e duhura profesionale të punës si dhe aparaturat matëse adekuate.</p> <p>7. Në rastet kur punëdhënësi angazhon persona apo institucion për shërbime nga siguria dhe shëndeti në punë, është i detyruar t'i informojë dhe njoftojë ata me procesin e punës, me rreziqet e mundshme, me rrethanat të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve dhe me masat parandaluese që i ka ndërmarrë për të krijuar kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës për të punësuarit.</p>	<p>protection and prevention of risks at work, neither by the employer, not by other employees.</p> <p>3. For the employee appointed to carry out safety and health at work activities, employer should provide necessary trainings and work equipment..</p> <p>4. When lacking qualified personnel to manage safety and health at work, employer within his/her company should hire people or institutions for external professional services.</p> <p>5. The Ministry, with a sub-legal act sets conditions and criteria for certification of individuals and institutions for services as per paragraph 4 of the present Article.</p> <p>6. External people or institutions for carrying out activities related to safety and health at work should be equipped with proper professional tools and equipment, and appropriate measuring instruments.</p> <p>7. In cases when employer engages people or institutions for safety and health at work services, he/she is obliged to inform them on the work process, potential risks, on circumstances that influence or might influence in employees' safety and health and with preventive measures taken to established safe and healthy work conditions for employees.</p>	<p>od strane poslodavca, ili ostalih zaposlenih.</p> <p>3. Za zaposlenog zaduženog, koji će obavljati poslove iz sigurnosti i zdravlja na radu, poslodavac mora da obezbedi obuku i sredstava potrebne za rad.</p> <p>4. Poslodavac, u nedostatku kvalifikovanog personala za vođenje sigurnosti i zdravlja na radu, u okviru svog subjekta će angažovati lica ili institucije za spoljne profesionalne usluge.</p> <p>5. Ministarstvo sa podzakonskim aktom određuje uslove i kriterije, za sertifikaciju osoba i institucija za usluge iz stava 4. ovog člana.</p> <p>6. Strana lica ili institucije za obavljanje aktivnosti u oblasti sigurnosti i zdravlja na radu, trebaju da se opreme sa potrebnim odgovarajućim sredstvima i opremom stručnog rada, kao i odgovarajućih mernih aparatura.</p> <p>7. U slučajevima kada poslodavac angažuje osobe ili institucije za usluge iz sigurnosti i zdravlja na radu i, dužan je, da ih informise, i obavestiti njih o procesu rada, sa potencijalnim rizicima, o okolnosti koje utiču ili mogu uticati na sigurnost i zdravlje zaposlenih i preventivnih mera koje je preduzeo da stvori sigurne i zdrave uslove rada za zaposlene.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 10 Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë</p> <p>1. Punëdhënësi i cili punëson deri në 50 të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 9, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5 të nenit 9.</p> <p>2. Punëdhënësi i cili punëson mbi 50 e më pak se 250 të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspertë, për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.</p> <p>3. Punëdhënësi i cili punëson më shumë se 250 të punësuar duhet të angazhojë një ose më shumë ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Employees in charge for safety and health at work</p> <p>1. Employer employing up to 50 employees, if competent, can personally take over the responsibility for implementing measures determined in Paragraph 1 of Article 9, with the conditions to meet conditions and criteria as per paragraph 5 of Article 9.</p> <p>2. Employer employing over 50 employees and less than 250 employees, is obliged to appoint an expert, for carrying out tasks related to safety and health at work.</p> <p>3. Employer employing over 250 employees should engage one or more experts to carry out activities related to safety and health at work.</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Zaposleni zaduzeni za sigurnost i zdravlje</p> <p>1. Poslodavac koji zapošljava do 50 radnika, ako je u mogućnosti /kompetentan, može da preuzme samo odgovornost za sprovođenje utvrđenih mera iz stava 1 člana 9, pod uslovom da ispunjavaju uslove iz stava 5. Člana 9.</p> <p>2. Poslodavac koji zapošljava više od 50 a manje od 250 zaposlenih, je dužan da odredi jednog eksperta za obavljanje dužnosti iz sigurnosti i zdravlja na radu.</p> <p>3. Poslodavac koji zapošljava više od 250 zaposlenih mora da odredi jednog ili više stručnjaka za obavljanje zadataka iz sigurnosti i zdravlja na radu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Ndihma e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i të punësuarve, rreziqet serioze dhe të mundshme</p> <p>1. Punëdhënësi është i detyruar të ndërmarrë masat e nevojshme për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarve, të përshtatura sipas natyrës së aktiviteteve dhe madhësisë së subjekteve punuese.</p> <p>2. Punëdhënësi është i detyruar të organizojë dhe t'i ofrojë ndihmën e parë të punësuarve në rast të</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Fire extinguishing, first aid, employee evacuation, serious and potential risks</p> <p>1. Employer is obliged to carry out necessary measures for first aid, fire extinguishing and evacuation of employees, adjust to the nature of activities and size of the company.</p> <p>2. Employer is obliged to organize and provide first aid to employees in case of injuries at work</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Prve pomoći, gašenje vatre, evakuacija zaposlenih, ozbiljni i potencijalni rizici</p> <p>1. Poslodavac je dužan da preduzme potrebne mere za pružanje prve pomoći, gašenja požara i evakuacije radnika, prilagođene prema prirodi aktivnosti i veličine privrednih subjekata, uzimajući u obzir drugih prisutnih lica.</p> <p>2. Poslodavac je dužan da organizuje i pruža prvu pomoć zaposlenih u slučaju povreda na radu ili</p>

<p>lëndimit në punë ose sëmundjeve të papritura dhe të sigurojë përcjelljen e tyre për trajtim mjekësor.</p> <p>3. Punëdhënësi trajnon personat, që do të kryejnë evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së parë.</p> <p>4. Punëdhënësi përmes personave të trajnuar, kryen evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së parë, për të punësuarit në subjektin punues.</p> <p>5. Punëdhënësi harton një plan për evakuimin dhe shpëtimin në situata emergjente, të cilin ia bën të ditur të gjithë të punësuarve, si dhe kryen ushtrime praktike, të paktën një herë në dy vjet, në përputhje me këtë plan.</p> <p>6. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë kontakte të nevojshme me shërbime të jashtme, sidomos lidhur me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbime shpëtimi dhe shërbimin e zjarrfikësve.</p> <p>7. Punëdhënësi, në rast të rrezikut të mundshëm dhe serioz për jetën dhe shëndetin e të punësuarve, duhet që:</p> <p>7.1. sa më shpejtë të jetë e mundur, t'i informojë të gjithë të punësuarit të cilët janë, apo mund të jenë të ekspozuar në rreze serioze dhe të mundshme, në mënyrë që të parandalojë ose zvogëlojë rrezikun për jetën</p>	<p>or unexpected illnesses and to proceed them to medical treatment.</p> <p>3. Employer provides training for individuals who will carry out evacuation, rescue, extinguish fire and provide first aid.</p> <p>4. Employer through trained individuals, carries out evacuation, rescue, fire extinguishing and first aid, for employees within the company.</p> <p>5. Employer develops a plan for evacuation and rescue in emergency situations, which he/she provides to all employees, and carries out practical exercise, at least once in two years, in accordance with the plan.</p> <p>6. Employer is obliged to maintain necessary contacts with external services, especially regarding first aid, emergency medical carer, rescue services and firefighter service.</p> <p>7. Employer, in case of serious and possible health-and life-threatening risk to employees, should:</p> <p>7.1. as soon as possible, inform all employees, who are or might be exposed to serious and potential risk, thus preventing or reducing the health- or life-threatening risk;</p>	<p>iznenadne bolesti do njihovog praćenja u lekarskom tretmanu.</p> <p>3. Poslodavac obučava osobe koji će izvršiti evakuaciju i spasavanje, gašenje požara i pružanje prve pomoći sa potrebnom opremom.</p> <p>4. Poslodavac prema treniranih osoba, vrši evakuaciju, spasavanje, gašenje požara i pružanja prve pomoći za zaposlene u privrednom subjektu.</p> <p>5. Poslodavac je dužan da izradi plan za evakuaciju i spasavanje u vanrednim situacijama, za koji će obavestiti sve zaposlene, kao i obavljati praktične vežbe najmanje jednom svake dve godine, u skladu sa ovim planom.</p> <p>6. Poslodavac dužan je da održava potrebne kontakte sa spoljnim uslugama, posebno u pružanju prve pomoći, hitne medicinske nege, usluge spasavanja i borbu protiv požara.</p> <p>7. Poslodavac , u slučaju potencijalnog i ozbiljan rizik za život i zdravlje zaposlenih, treba da:</p> <p>7.1. što je pre moguće, obavesti sve zaposlene koji su ili mogu biti izloženi ozbiljnim rizicima i mogućim , u cilju sprečavanja ili smanjenja rizika po život i zdravlje ljudi ;</p>
---	--	---

<p>dhe shëndetin;</p> <p>7.2. të marrë masa dhe të japë udhëzime për t'iu mundësuar të punësuarve, që në rast të rreziqeve serioze dhe të mundshme në vendin e punës ta ndërpresin punën dhe menjëherë ta braktisin atë vend të punës dhe të vendosen në një vend të sigurt;</p> <p>7.3. të përmbahet nga kërkesa drejtuar të punësuarve që të vazhdojnë punën në situatë kur ende ka rrezik serioz dhe të mundshëm;</p> <p>7.4. të angazhojë në punë për evitimin e rrezikut dhe normalizimin e procesit të punës, vetëm të punësuarit e kualifikuar, të specializuar dhe të trajnuar për kryerjen e punëve në kushte të veçanta dhe me rrezikshmëri të lartë;</p> <p>7.5. të organizojë vazhdimin e procesit të punës vetëm pas kalimit të rrezikut, përveç në rastet e jashtëzakonshme dhe objektivisht të justifikuara kur ndërprerja e procesit të punës shkakton dëme më të mëdha në njerëz.</p> <p>8. Të punësuarit në rastet kur janë të rrezikuar seriozisht dhe të cilët nuk mund të kontaktojnë menjëherë me eprorin përgjegjës do të veprojnë sipas aftësive të tyre të fituara me trajnime dhe pajisjeve teknike që kanë në dispozicion, për të shmangur pasojat e një rreziku të tillë.</p> <p>9. Të punësuarit të cilët veprojnë në përputhje</p>	<p>7.2. take measures and provide instructions to allow employees, in case of serious and potential risks at work, to leave the workplace and immediately abandon it and move to a safer place;</p> <p>7.3. Refrain from requests for employees to carry on with the work in situations when there is still serious and potential risk;</p> <p>7.4. Engage only qualified, specialized and trained employees to avoid risk and normalize the work process in special conditions with high risk;</p> <p>7.5. Organize the continuation of the work process only after the risk has passed, except in extraordinary and objectively justifiable cases when interruption of the work process causes larger damages in people.</p> <p>8. Employees when facing a serious risk and who are not able to immediately contact their senior will act based on their skills acquired in training and technical equipment available to them, to avoid the consequences of such risk.</p> <p>9. Employees acting in accordance with</p>	<p>7.2. preduzme mere i obezbedi uputstva da omogući zaposlenima , u slučaju ozbiljnih rizika i potencijala na radnom mestu da zaustavi rad i odmah napuste radno mesto i biti postavljen na bezbednom mestu;</p> <p>7.3. da se pridržavaju od zahteva upucena zaposlenima, da nastave raditi u situaciji kada još uvek postoji ozbiljna i potencijalna pretnja;</p> <p>7.4. da se uključe u rad da se izbegne rizik i normalizaciju rada procesa, samo kvalifikovane zaposlene, specijalizovane i obučavani da obavljaju rad pod posebnim uslovima i na visok rizik;</p> <p>7.5. da organizuje ostatak procesu rada tek nakon rizika, osim u izuzetnim slučajevima i objektivno opravdanje kada prekid procesa rada izaziva najveću štetu na ljudima.</p> <p>8. Kada su zaposleni u ozbiljnoj opasnosti i koji se ne mogu odmah kontaktirati odgovornu supervizora će delovati u skladu sa svojim sposobnostima i obuku zaradili tehničku opremu na raspolaganju, kako bi se izbegle posledice takvog rizika.</p> <p>9. Zaposleni koji postupaju u skladu sa stavom 8.</p>
--	---	---

me paragrafit 8 të këtij neni, nuk do të kenë përgjegjësi për pasojat e mundshme, përveç në rastet kur ata veprojnë qëllimisht në kundërshtim me udhëzimet për veprim ose nuk veprojnë fare duke neglizhuar rrezikun.

Neni 12

Detyrimet e punëdhënësit për caktimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale

1. Punëdhënësi, për caktimin e masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, është i detyruar që të:

1.1. miratojë fazën e kërkimit, të projektimit dhe hartimit të planit për përdorimin e pajisjeve të punës, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;

1.2. përpilojë një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut që përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieniko-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës për veprimtarinë përkatëse;

1.3. përcaktojë cilësitë dhe përgjegjësitë e të punësuarit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, në përshkrimet e punës, sipas pozicionit përkatës të punës.

paragraph 8 of the present Article, will not be held responsible for possible consequences, except in cases when their deliberately act contrary to instructions or do not act by neglecting the risk.

Article 12

Employers' duties for determining measures for the prevention of accidents at work and professional illnesses

1. Employer, with the aim of determining measures for the prevention of accidents at work and professional illnesses, is obliged to:

1.1. approve the stage for the search, projection and development of the plan for the use of work equipment, pursuant to the provisions of the current Law and other applicable Laws, leading to the reduction and avoidance of risks, accidents at work and professional illnesses;

1.2. Develop a risk assessment and prevention document comprising measures with technical, organizative, sanitary and hygienic measures, which will be applied in specific conditions of the work places of the company;

1.3. Set qualities and responsibilities of employee in the field of safety and health at work, in their job descriptions, according to the position of an employee.

ovog člana ne može biti odgovoran za moguće posledice, osim ako oni namerno postupa suprotno uputstvima koje deluju ili ne deluju uopšte zanemarujući.

Član 12

Obaveze poslodavaca da razvije mere za sprečavanje nesreća na radu i profesionalnih oboljenja

1. Poslodavac, za određenje mera za sprečavanje nesreća na radu i profesionalne bolesti, dužan je da:

1.1. odlučuje u fazi istraživanja, projektovanja i izgradnje objekata, stavljajući na rad opreme i tehnologije koji će se koristiti, u skladu sa zakonskim odredbama ovoga zakona i drugim zakonima, koji će voditi do smanjenja i sprečavanja rizike na radu i za profesionalne bolesti;

1.2. izraditi jedan dokument procene prevencija rizika koji sadrži mere sa tehničkim organizacionim karakterom, higijeno-sanitarni, procenujući rizik, koji će se primeniti pod posebnim uslovima radnog mesta delatnosti;

1.3. definišu kvalitete i odgovornosti posloprimalaca u oblasti bezbednosti zdravlja na radu, na opisi poslova, prema odgovarajućom poziciji rada.

<p align="center">Neni 13</p> <p align="center">Detyrimet e punëdhënësit për zbatimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale</p>	<p align="center">Article 13</p> <p align="center">Duties of employer in implementing measures for the prevention of accidents at work and professional illnesses</p>	<p align="center">Član 13</p> <p align="center">Obaveze poslodavca za garantovanje sprovođenja mera za sprečavanje nesreća na radu i profesionalnih bolesti</p>
<p>1. Për garantimin e zbatimit të masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, punëdhënësi është i detyruar që të:</p> <p>1.1. mbikëqyrë punën dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve të personave ose të shërbimeve të jashtme të kontraktuara prej tij për sigurinë dhe shëndetin në punë;</p> <p>1.2. ndërmarrë masat për të siguruar materialet e nevojshme për informimin dhe trajnimin e të punësuarve dhe të vendosë shenja adekuate për siguri, postera, fletushka, filma, filmime të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë;</p> <p>1.3. sigurojë informimin e çdo të punësuarit përpara fillimit të punës për rreziqet ndaj të cilave ai mund të ekspozohet në vendin e tij/saj të punës, si dhe për masat e nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse;</p> <p>1.4. sigurojë që të punësuarit të jenë të pajisur me kualifikimet përkatëse profesionale;</p> <p>1.5. sigurojë funksionimin e vazhdueshëm dhe të duhur të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse, mjeteve të matjes dhe të kontrollit, si dhe të pajisjeve të diktimit, mbajtjes nën kontroll dhe neutralizimit të</p>	<p>1. For ensuring the implementation of measures to prevent accidents at work and professional illnesses, employers must:</p> <p>1.1. supervise the work and quality of services provided of the external Individual or institutions contracted for The serviles related to safety and health at work;</p> <p>1.2. take measures to provide required information and training materials for employees and to install proper safety signs, posters, leaflets, films and recordings related to safety and health at work;</p> <p>1.3. provide information to each employee prior to commencing the work on risks he/she may be exposed at his/her workplace, and on necessary preventive and protective measures;</p> <p>1.4. ensure that employees are equipped with relevant professional qualifications;</p> <p>1.5. to ensure continuous and proper functioning of protection systems and equipment, measuring and control tools and dictation, controlling and chemical substance neutralization instruments,</p>	<p>1. Da bi se garantovalo sprovođenje mera za sprečavanje povreda na radu i profesionalnih oboljenja, poslodavac je dužan da:</p> <p>1.1. nadzire rad osoba ili njegovih ugovorenih eksternih usluga za bezbednosti i zdravlja na radu ;</p> <p>1.2. preduzeti mere da se obezbedi potreban materijal za informisanje i obučavanje zaposlenih, kao što su posteri, brošure, filmovi, video koji se odnose na bezbednost i zdravlje na radu;</p> <p>1.3. pruži informacije bilo koje osobe pre početka rada na rizike kojima može biti izložena na radnom mestu, kao i preventivne i zaštitne mere potrebne;</p> <p>1.4. obezbedi da zaposleni dobijaju relevantn profesionalne kvalifikacije;</p> <p>1.5. obezbedi kontinuirano funkcionisanje i potrebno sistema i zaštitnih sredstva, zaštitnih mera, mernih sredstava i kontrole kao i sredstava diktiranja uspostavljaajući svoju kontrolu i neutralizaciju opasnih</p>

<p>substancave të rrezikshme që lirohen gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike;</p> <p>1.6. marrë në punë të punësuarin në bazë të ekzaminimit mjekësor të tij, në varësi të vendit të punës;</p> <p>1.7. lejojë përfaqësuesin e të punësuarve, me kërkesën e këtij të fundit, të marrë pjesë gjatë vizitës së inspektimit, si dhe në rastet e hetimit të ngjarjeve;</p> <p>1.8. lejojë të punësuarin të marrë pjesë në inspektimin dhe hetimin e ngjarjeve, me kërkesën e inspektorit të punës;</p> <p>1.9. ruajë të gjitha provat në vendngjarje ku ka ndodh aksidenti me pasojë vdekjeje, qoftë ky dhe kolektiv, me përjashtim të rasteve kur ruajtja e atyre provave në vendngjarje mund të shkaktojë një tjetër aksident;</p> <p>1.10. sigurojë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit dhe të njëjtat të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit;</p> <p>1.11. mbajë në gjendje të rregullt dhe t'i rimbushë në afate të caktuara të cilat shënohen në tiketën e vendosur në aparat;</p> <p>1.12. vendosë në vende të përshtatshme aparatet për fikjen e zjarrit;</p>	<p>released during the work process;</p> <p>1.6. recruit an employee based on medical examination, depending on the workplace;</p> <p>1.7. allow the representative of employees, upon the latter's request, to participate during the inspection visit, and also during investigations;</p> <p>1.8. allow employee to participate in inspection and investigation, upon the request of a labour inspector;</p> <p>1.9. save all evidence at the scene where a fatal accident has occurred, even if it is collective, except in cases when saving such evidence at the scene may cause another accident;</p> <p>1.10. provide sufficient number of fire extinguishers with proper filling according to the type of fire cause;</p> <p>1.11. Maintain and re-fill at certain deadlines fire extinguishers as written in the label;</p> <p>1.12. Install fire extinguishers at appropriate locations;</p>	<p>supstanci koje se oslobađaju tokom razvoja tehnoloških procesa;</p> <p>1.6. da zapošljavaju svakog zaposlenog na osnovu njegovog lekarskog pregleda, u zavisnosti od posla;</p> <p>1.7. dozvoliti predstavnika zaposlenih, sa njegovim zahtevom, ovog krajnjeg, da učestvuju u toku inspeksijske posete, kao i u slučajevima istrage događaja;</p> <p>1.8. omogućiti zaposlenima da učestvuju u inspektovanju i istragu o događajima na zahtev inspektora rada;</p> <p>1.9 sačuvaju sve dokaze o mestu događaja gde se dogodio aksidenta sa smrtnim ishodom, bilo da je i kolektivan, izuzev slučajeva kada očuvanje dokaza u mesto događaja moze da ugrožava jedan drugi aksidenat;</p> <p>1.10. Obezbedi dovoljan dovojan broj aparata za gasenje vatre i iste biti adekvatno punjene prema uzroku požara;</p> <p>1.11. održi u dobrom stanju i ponovo puni u odredjenom roku koji su evidentirani na etiketi koja se nalazi na aparatu;</p> <p>1.12. smestiti u odgovarajuće mesto, aparate za gašenje požara;</p>
---	---	--

<p>1.13 instalojë hidrantë në subjektet punuese ku ka rrezik të shtuar për shpërthimin e zjarrit dhe ku konsiderohet që aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të mjaftueshme;</p> <p>1.14. vendosë hidrantet në vende të dukshme, të përshtatshme dhe duhet të jenë në gjendje të rregullt për përdorim në çdo kohë;</p> <p>1.15. të shënojë qartë ndalimin e pirjes së duhanit në vendet e punës dhe në vende publike;</p> <p>1.16. pajisë të punësuarit, në mënyrë të detyrueshme, me pajisje mbrojtëse individuale, të sigurojë mirëmbajtjen e tyre dhe të respektojë afatet e skadimit të përdorimit të tyre.</p>	<p>1.13. Sinstall hydrants in companies with higher risk of fire and where it is considered that fire extinguishers are not sufficient to fight fires;</p> <p>1.14. Install hydrants in visible, appropriate locations and hydrants to be ready for use at any given time;</p> <p>1.15. Tto mark clearly smoking prohibition signs at workplaces and in public places;</p> <p>1.16. Mandatory, equip employees with individual protection equipment, ensure their maintenance and respect the expiration of utilization deadlines.</p>	<p>1.13 instalirati hidrante u radnim predmetima u kojima postoji povećana opasnost od požara i , gde se smatra da uređaji, za gašenje požara nisu dovoljno;</p> <p>1.14. postaviti hidranata na vidljivim mestima, odgovarajućim , i trebalo bi da budu u ispravnom stanju za upotrebu u svako vreme;</p> <p>1.15. Jasno označiti zabranu pušenja u radnim i javnim mestima;</p> <p>1.16. obezbediti zaposlene, na obaveznom nacinu, sa individualnom zaštitnom opremom, obezbediti njihovo održavanje i postovati rokove isteka njihovog korišćenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Përdorimi i mjeteve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse individuale gjatë procesit të punës</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Utilization of working kit and individual protection equipment during the work process</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Korišćenje radnih sredstava i individualne zaštitne opreme u toku procesa rada</p>
<p>1. Punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i mbajë në gjendje të rregullt, ta kontrollojë rregullsinë dhe sigurinë e tyre me kontrolla të herëpashershme në afate të përcaktuara me aktin që e miraton ai, përkatësisht me udhëzimin e prodhuesit, dispozitat dhe standardet teknike.</p> <p>2. Nëse me udhëzimin e prodhuesit nuk janë parashikuar afate të tjera, punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i kontrollojë,</p>	<p>1. Employer is obliged to maintain properly the work equipment, check their proper functioning and safety with periodical controls in determined deadlines by an act endorsed by him/her, respectively in accordance with manufacturer's instructions, dispositions and technical standards.</p> <p>2. If by manufacturer's instructions, no other deadline is set, employer is obliged to ckeck, try and test the working tools;</p>	<p>1. Poslodavac je dužan da radna sredstva održi u ispravnom stanju , da povremeno kontroliše njihovu pravilnost i sigurnost koja se vrše na načinu i pod rokovima utvrđenim aktom, kojeg on odobrava,odnosno sa uputstvom proizvođača,odredama i tehničkim standardima.</p> <p>2. Ako sa uputstvom proizvođača nisu predviđeni drugi rokovi, poslodavac je dužan da radna sredstva kontroliše i proba :</p>

<p>provojë dhe testojë:</p> <p>2.1. para përdorimit të parë,</p> <p>2.2. pas rekonstruktimit, pas avarisë dhe</p> <p>2.3. pas zhvendosjes nga njëri vend në vendin tjetër.</p> <p>3. Punëdhënësi duhet të sigurojë që mjetet e punës dhe pajisjet individuale mbrojtëse, të jenë në gjendje të mirë dhe të rregullt në çdo kohë.</p> <p>4. Punëdhënësi nuk mund të përdorë apo të vërë në punë, mjetet dhe pajisjet për mbrojtje individuale, në qoftë se ato nuk i përgjigjen standardeve teknike në përputhje me rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.</p>	<p>2.1. prior to first use;</p> <p>2.2. after reconstruction, after defects, and</p> <p>2.3. after moving the equipment from one spot to another.</p> <p>3. Employer must ensure that individual working tools and protection equipment are in good working condition at any given time.</p> <p>4. Employer can not use working tools and individual protection equipment, if they are not compliant with technical standards and in accordance with safety and health at work rules.</p>	<p>2.1. pre prve upotrebe;</p> <p>2.2. posle rekonstrukcije ili nakon oštećenja i</p> <p>2.3. posle prelaska sa jednog mesta na drugo mesto .</p> <p>3. Poslodavac mora da obezbedi da sredstva za rad i opremu za ličnu zaštitu, da budu u dobrom stanju u svakom trenutku.</p> <p>4. Poslodavac ne može da koristi ili da uspostavlja na rad, opreme za individualnu zaštitu, ukoliko nisu u skladu sa tehničkim standardima u skladu sa propisima.sigurnosti i zdravlje na radu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Objektet/ndërtesat</p> <p>1. Për çdo objekt / ndërtesë, të destinuar për punë, punëdhënësi duhet të sigurojë:</p> <p>1.1. planin për evakuim në mënyrë që të punësuarit të evakohen nga objekti/ndërtesa, në rastin e ngjarjeve të papritura, prej të cilave rrezikohet jeta dhe shëndeti i tyre;</p> <p>1.2. që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të shënuara qartë me shenja adekuate, të cilat do të vendosen në vende të dukshme dhe në përputhje me rregullat;</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Buildings/Premises</p> <p>1. For each premise/building, destined for work, employer must provide:</p> <p>1.1. evacuation plan in order that employees are evacuated from the premises/building, In case of unexpected occurrence, which Threatens employees' health and life;</p> <p>1.2. emergency exits are marked with proper signs, installed in visible locations and in accordance with relevant rules;</p>	<p style="text-align: center;">Član15 Objekti / zgrade</p> <p>1. Za svaki objekat / zgradu, namenjeno za rad, poslodavac treba da obezbedi:</p> <p>1.1. plan evakuacije, tako da zaposlenom u slučaju neočekivanih događaja, može da im se ugrožava njihov život ili zdravlje;</p> <p>1.2.da emergentni putevi i izlazi da budu posebno označeni u skladu sa naznacenim znakovima, koja ce se postaviti u vidljivim mestima i u skladu sa pravilima;</p>

<p>1.3. që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të lira, pa pengesa dhe të cilat të dërgojnë direkt jashtë zonës së rrezikshme apo në një zonë të sigurt;</p> <p>1.4. hapësirën për dhënien e ndihmës së parë dhe pajisjet e nevojshme;</p> <p>1.5. hapësirën e nevojshme për pushim;</p> <p>1.6. hapësirat ndihmëse (dhoma për ushqim, dhoma e veshjeve/garderoba, banjo, tualetet ndaras për femra dhe meshkuj);</p> <p>1.7. dhoma për pirjen e duhanit, objektet për pastrimin dhe dezinfektimin e rrobave të punës dhe pajisjet mbrojtëse.</p>	<p>1.3. emergency ways and exits are free without obstacles and which lead directly out of hazardous area or to a safe area;</p> <p>1.4. space for the provision of first aid and required equipment;</p> <p>1.5. necessary resting area;</p> <p>1.6. auxiliary spaces (canteen, wardrobe, baths, separate toilets for men and women);</p> <p>1.7. smoking rooms, laundry for the working outfit and protective equipment.</p>	<p>1.3. da emergentni putevi i izlazi budu slobodni i koji vode direktno van zone ili u jednoj zaštićenoj sigurnoj zoni;</p> <p>1.4. prostor za prvu pomoć i potrebnu opremu;</p> <p>1.5. potrebni prostor za odmor ;</p> <p>1.6.pomocni prostori (sobe za hranu, odeću / garderobu, kupatilo, toilet odvojeno za muškarce i žene),</p> <p>1.7. prostorija za pušače, objekata za čišćenje i dezinfekciju radne odeće i zaštitne opreme.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Risk assessment at workplaces</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Procena rizika u radnim mestima</p>
<p>1. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës.</p> <p>2. Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës bëhet nga profesionistë të fushave përkatëse brenda subjektit punues të caktuar nga punëdhënësi, përkatësisht nga shërbimet e jashtme ose personat e kontraktuar nga punëdhënësi.</p>	<p>1. Employer is obliged to carry out risk assessment at workplaces, in order to prevent the risk, including exposure of employees to elements harmful and hazardous for safety and health at work during the working process</p> <p>2. Risk assessment at workplaces is carried out by experts of relevant fields within the company, appointed by the employer, respectively by external individuals or services contracted by the employer.</p>	<p>1. Poslodavac, u cilju zaštite zdravlja i bezbednosti na radu, dužan je da proceni rizik po život i zdravlje zaposlenih, njihovo sprečavanje ili smanjenje, uključujući i one grupe radnika koji su izloženi određenim rizicima za sigurnost i zdravlje na radu.</p> <p>2. Procena rizika na radnom mestu obavlja se od strane profesionalaca iz odgovarajuće oblasti u okviru radnog entiteta određenog od strane poslodavca, odnosno iz spoljnih usluga ili lica koje je ugovorio poslodavac.</p>

<p>3. Punëdhënësi, pas procesit të vlerësimit të rrezikshmërisë, është i detyruar të hartojë dokumentin e vlerësimit të rrezikut dhe të ndërmarrë masat mbrojtëse të domosdoshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve.</p> <p>4. Mënyra e përgatitjes së dokumentit për vlerësimin rrezikut, përmbajtja e tij si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut, rregullohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria, në pajtim me ministrinë kompetente për çështjet e shëndetësisë.</p> <p>5. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë evidencën për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisë të lënduarin me fletëlëndim në vend të punës.</p> <p>6. Punëdhënësi është i detyruar që në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për siguri dhe shëndet në punë, të hartojë raporte mbi aksidentet dhe sëmundjet profesionale në subjektin e tij punues.</p>	<p>3. Employer, after the risk assessment process, is obliged to develop a risk assessment document and take protective measures necessary for employees' safety and health at work.</p> <p>4. Method for developing the risk assessment document and its content are regulated by a sub-legal act developed by the Ministry, in accordance with the competent ministry on charge of health issues.</p> <p>5. Employer is obliged to keep records on accidents at work, professional illnesses and equip the injured with relevant injury note at the workplace.</p> <p>6. Employer is obliged, in cooperation with authorities responsible for safety and health at work, to develop reports on accidents and professional illnesses at his/her company.</p>	<p>3. Poslodavac, posle procesa procene rizika, je dužan za pripremu dokumenat procene rizika i preduzeti neophodne zaštitne mere za bezbednost i zdravlje na radu zaposlenih.</p> <p>4. Način pripreme dokumenta o proceni dokumenata rizika, njenom sadržaju i podacima na kojima treba da se bazira procena rizika, reguliše se sa podzakonskim aktom, kojeg donosi ministarstvo, u skladu sa ministrom nadležnim za zdravstvena pitanja.</p> <p>5. Poslodavac je dužan da vodi evidenciju o povredama, profesionalnih oboljenja i da obezbede povrednog sa povrednom listom na radnom mestu.</p> <p>6. Poslodavac je dužan da, u saradnji sa nadležnim organima za sigurnost i zdravlje na radu, da izradu izveštaja o aksidentu na radu i profesionalne bolesti u subjektu svog rada.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Punët me kushte të veçanta</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Labour under special conditions</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Radovi sa posebnim uslovima</p>
<p>1. Punë me kushte të veçanta sipas dispozitave të këtij Ligji, janë punët që mund të kryhen vetëm nga të punësuarit të cilët përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës, duhet të përmbushin edhe kushtet dhe kriteret e veçanta të moshës, gjinisë, aftësisë profesionale, shëndetësore, fizike, gjendjes mendore, psiko-fizike dhe psikologjike.</p>	<p>1. Labour under special conditions according to applicable provisions are works that are carried out only by employees who in addition to general conditions on establishing labour relations, must meet conditions and criteria regarding age, sex, professional skills, health, physical and mental condition and psychological condition</p>	<p>1. Rad sa posebnim uslovima u skladu sa odredbama ovog zakona, su dela koja se mogu obavljati samo zaposleni koji, pored uspostavljanja opšte uslove zapošljavanja, mora da ispunjava posebne uslove na godine, pol, profesionalnu sposobnost, zdravlje, fizičko ili mentalno stanje, kao psiho-fizičke i psihičke.</p>

